



Janar 2016

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shkurt

Mars

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Janar 2016

© Ministria e Financave, 2016

Drejtoria e Makroekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: marsed.harizi@financa.gov.al

eva.doda@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore


- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin janar 2016 arriti në 100.8 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin janar 2016 ishte 1.5 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin janar 2016 ishte 127.37 lekë për dollarë dhe 138.35 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit janar 2016 shënuan kuotat 1.18 për qind për ato 12-mujore, 0.9 për qind për 6-mujoret ,0.5 për qind për depozitat 3-mujore dhe 1.14 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.29 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.24 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,211,534.4 milionë lekë në muajin janar, duke shënuar një rritje prej rreth 2 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për tremujorin e tretë të 2015-ës rezultoi me një suficit të bilancit të përgjithshëm prej 314.3 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën muajin janar 2016 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 8.8 miliardë lekë, që do të thotë se rreth 153% (ose rreth 3.1 miliardë lekë) më shumë se planifikimi mujor (ndërkohë që suficiti ishte planifikuar 5.8 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë muajit janar 2016, arritën në rreth 32.5 miliardë lekë ose afërsisht 101.3 për qind e planit mujor.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 23.7 miliardë lekë ose 90 për qind e shpenzimeve të planifikuara për muajin janar.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin janar 2016 ishte +1.5%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 1,3 %. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin janar 2016 shënoi rritje prej 0.9 për qind krahasuar me muajin dhjetor 2015. Ky indeks ka shënuar rritje prej 0.3 për qind edhe gjatë muajit dhjetor krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa, gjatë muajit nëntor 2015, ky indeks shënoi rënie me -0.32 për qind krahasuar me muajin tetor 2015. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë, kanë shënuar rritje me 1.4 për qind për janar, rritje me 0.7 për muajin dhjetor dhe rënie me -0.2 për qind për muajin nëntor të vitit 2015.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria me kontribut më të lartë në inflacionin e përgjithshëm prej +2% në muajin janar ishin “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.3%, duke kontribuar me +1.5 pikë, “Pije alkoolike dhe duhan” me një rritje vjetore të çmimit prej +3.3%, duke kontribuar me +0.16 pikë përqindje dhe “Shërbimi arsimor” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.19 pikë përqindje.



Rënia më e madhe gjatë muajit janar u konstatua në kategorinë “Qira, ujë, lëndë djegëse” dhe “Transport” me rënie përkatësisht -3.7 dhe -2.5 për qind. Peshat specifike që zënë këto grupe në shportën e mallrave të konsumit, bënë që ndryshimet e çmimeve për këto grupe të kenë efekt mbi normën e inflacionit me nga -0.27 dhe -0.16 pikë përqindje.

Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitin 2015 dhe për periudhën janar 2016 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4	1.3	1.9	2.2	2.1	2.1	2.0
2016	1.5											

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin janar 2016, arriti në 138.35 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.5 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit janar, një euro u këmbye me 138.68 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin janar 2016 arriti në 127.37 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 0.58 për qind kundrejt muajit dhjetor 2015. Në fund të muajit janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 127.06 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 5.5 për qind, ndërsa kundrejt monedhës evropiane rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar në masën -1.2 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane dhe mbiçmimi ndaj monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.




Fig-2

Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit janar 2016

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kursi i këmbimit të Euros me Dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatar rreth 0.92 dollarë/euro duke ruajtur të njëjtin nivel si një muaj më parë. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, etj.


3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit janar 2016, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 1.18 dhe 0.9 për qind duke shënuar respektivisht rënie prej -0.9 dhe -0.27 pikë përqindje krahasuar me muajin dhjetor 2015. Rënie për këtë muaj kanë shënuar edhe normat e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujore duke arritur në nivelin 0.50. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1-mujore për muajin janar 2016 kanë shënuar rritje me 0.26 krahasuar me një muaj më parë duke arritur në nivelin 1.14 për qind.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej -0.38 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1- mujor që kanë arritur nivelin 0.14 për qind për janar 2016.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit janar 2016 shënoi rritje me 0.82 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 8.29 për qind krahasuar me muajin dhjetor 2015. Gjithashtu norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rritje me 0.89 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 9.24 për qind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit janar 2016, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 2.1 dhe 1.9 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie në *yield*-in e këtyre bonove të thesarit përkatësisht me 0.30 dhe 0.47 pikë përqindje.


Fig-3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë



4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për tremujorin e tretë të 2015 regjistroi një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 314.3 milionë euro, duke pësuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ku regjistroi një tepricë prej 153.9 milionë Euro. “Llogaria kapitale dhe financiare” për tremujorin e tretë të 2015 rezultoi të jetë me një deficit prej -378.1 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Llogaria korente për tremujorin e tretë të vitit 2015 e thelloi deficitin e saj në rreth -325.6 milionë euro nga rreth -296 milionë euro që rezultonte në tremujorin e tretë të vitit 2014. Ky efekt negativ i llogarisë korente në balancin e pagesave është kompesuar nga përmirësimi i vazhdueshëm i llogarisë financiare dhe kapitale, e cila regjistroi një rritje me 31.12% për tremujorin e tretë 2015, kundrejt tremujorit të tretë 2014, si dhe 20.5% në terma vjetore. Kompozicioni i llogarisë korrente prej -325.6 milionë euro është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2015:

- (i) bilanci tregtar me -608.4 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 133.8 milionë euro,
- (iii) të ardhura netome -23.1 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 172.1 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.





5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit janar 2016, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 82,592.7 miliardë lekë krahasuar me muajin janar të vitit 2015. Kjo rritje ka ardhur më së shumti si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 62,229.4 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 20,363.3 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,211,534.4 milionë lekë në muajin janar, duke shënuar rritje prej rreth 2 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin janar 2016, sistemi bankar rezulton me një rritje prej 9,049.7 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin dhjetor 2015. Rritja për këtë muaj ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me 7,478.7 miliardë lekë.



6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin janar 2016 arriti në 542,790.7 miliardë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin janar 2015 shënoi rënie me vlerë -14,876 miliardë lekë, pra rënie prej rreth -2.67 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 56.3 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 305,740 milionë lekë.

Gjatë muajit janar 2016, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 65.0 për qind ose 353,032 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 28.19 për qind ose 153,025 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.05 dhe 1.55 për qind apo 27,420 dhe 8,434 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin janar 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 53.76 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 34.90 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.78 për qind dhe rreth 23.00 për qind.




Fig-9

Rritja e stokut total të kredive

Burimi: Banka e Shqipërisë




Fig-10


Përberja e kredive Janar '16

Burimi: Banka e Shqipërisë

7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin janar 2016 shënoi rënie me 0.33 për qind krahasuar me muajin paraardhës dhjetor 2015. Kjo ofertë arriti në rreth 225,423.1 milionë lekë në fund të muajit janar 2016, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin janar 2015 prej 0.51 për qind.


Fig-11



Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin janar 2016, kanë pësuar rënie prej -12,446.2 milionë lekë në krahasim me muajin janar 2015. Depozitat në valutë gjatë muajit janar 2016 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 84.8 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 85.9 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3
Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit janar 2016, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.1 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.9 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.8 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 84.8 për qind dhe rreth 13.3 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 87.1 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 847,245.1 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (114,327.5 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (13,361.1 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (9,379.1 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,798.8 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit janar 2016, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi rënie prej -1,156.1 milionë lekë si rezultat i rënies së depozitave në lekë me rreth -6,283.6 milionë lekë.

Fig-14




Përberja e depozitave Janar 2016

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin janar 2016 janë mbledhur rreth 32.5 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 23.7 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 22.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 1.2 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 96% janë financime të jashtme.



Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 21.1 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 643 milionë lekë (ose rreth 67% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 7.8 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 2.6 miliardë lekë (ose rreth 70% e planit vjetor).

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 101.3% të të ardhurave buxhetore për planifikimin mujor, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 90% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 94% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 64% të planit të tij mujor.

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 22.5 miliardë lekë, 5.4 miliardë lekë (24% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 3.3 miliardë lekë (15%) për interesat, 1.2 miliardë lekë (5%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 54 milionë lekë (0.2%) për subvencione, 10.3 miliardë lekë (46%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.4 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 834 milionë lekë (4%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 8% (shpenzime personeli), 8% (shpenzime për interesat), 3% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 3% (subvencione), 7% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 3% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 4% shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 0.1%, ndërsa financimi i huaj është 4% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin janar 2016 ishin rreth 32.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 29.5 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 2.6 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë muajin janar 2016 (mld Lekë)
Revenues during January 2016 (in billion ALL)

Burimi (Source)	jan'16 Jan'16	jan'15 Jan'15	Ndrysh(% Chang (%)
TVSH (VAT)	10.1	9.4	7.4
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	1.5	0.59	150
Taksa doganore (Custom Tax)	0.39	0.35	11.4
Taksat nacionale (National Tax)	3.2	1.6	100
Akcizat (Excise)	2.8	1.8	55.6
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.2	1.9	68.4

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: janar – 2016;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: janar – 2016;

1. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 8.8 miliardë lekë, në fund të muajit janar 2016, u mbështet kryesisht nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 28% të totalit të deficitit) dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj (rreth 45% të totalit të deficitit).

Për muajin janar 2016, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 32,526 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 23,710 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin janar 2016, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 29.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 22.5 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 1.2 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1																			
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	
Janar	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	0.80	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	January
Shkurt	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4		1.55	1.0	1.05	1.1	1.9		4.5	0.6	2.5	1.9	2.3		February
Mars	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4		1.00	0.8	0.77	0.9	1.4		4.3	1.0	2.4	2.2	2.2		March
Prill	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5		0.60	0.6	0.55	0.5	0.9		4.1	1.6	2.3	1.7	2.3		April
Maj	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6		0.26	0.3	0.24	0.2	0.5		4.2	1.9	2.1	1.6	1.8		May
Qershor	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1		0.04	0.1	0.15	0.1	0.1		3.9	2.2	2.3	1.5	1.4		June
Korrik	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7		-0.07	0.1	-0.03	0.0	0.2		3.6	2.7	1.6	1.8	1.3		July
Gusht	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8		-0.02	0.1	-0.04	0.0	0.1		3.1	2.8	1.2	2.0	1.9		August
Shtator	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6		0.02	0.1	0.06	0.0	0.2		2.8	2.6	1.7	1.5	2.2		September
Tetor	0.4	0.2	0.1	0.1	0.01		0.06	0.1	0.05	0.0	0.2		3.0	2.4	1.7	1.4	2.1		October
Nëntor	0.1	0.2	-0.5	-0.2	-0.3		0.06	0.1	0.01	0.0	0.1		2.9	2.5	1.0	1.7	2.1		November
Dhjetor	1.0	0.9	1.7	0.7	0.6		0.14	0.2	0.15	0.1	0.17		1.7	2.4	1.9	0.7	2.0		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Currency
						Janar	
<i>Mesatarja e periudhës</i>							<i>Average of period</i>
USD	100.90	108.18	105.67	113.64	126.64	127.37	USD
EURO	140.33	139.04	140.27	140.11	137.65	138.35	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>							<i>In the end of period</i>
USD	107.54	105.85	101.86	115.23	125.79	127.06	USD
EURO	138.93	139.59	140.20	140.14	137.28	138.68	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2011	2012	2013	2014	2015	2016	In percent
						Janar Jan	
Norma e depozitave							Deposits rates
12-M	5.87	5.38	4.17	1.51	1.27	1.18	12-M
6-M	4.87	4.50	3.40	1.16	1.17	0.90	6-M
3-M	4.22	3.83	2.72	0.83	0.54	0.50	3-M
1-M	4.39	3.62	2.79	1.47	0.88	1.14	1-M
Norma e huasë							Lending rates
12-M	11.17	10.28	9.52	7.00	7.47	8.29	12-M
6-M	12.28	10.61	9.59	8.18	8.35	9.24	6-M
Norma e letrave me vlerë							Securities rates
Bono thesari 1/							Treasury bills 1/
3-M	5.31	5.03	3.40	3.15	-	1.45	3-M
6-M	6.23	5.65	3.54	3.16	2.46	1.99	6-M
12-M	6.95	6.37	3.66	3.33	2.40	2.10	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2016

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,526	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	335	Grands
II.	Të ardhura tatimore	29,543	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	21,137	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,069	V. A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,477	Profit Tax
3	Akcizat	2,789	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,218	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,187	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	398	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pussteti Vendor	643	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	193	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	74	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	376	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	7,762	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	7,031	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	625	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	106	Revenues for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,648	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,005	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	0	Divident
4	Tarifat shërbimeve	471	Tariffs on services
5	Të tjera	172	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	23,710	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	22,489	Current Expenditures
I.1	Personell	5,430	Personnel expenditures
1	Paga	4,657	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	773	Social insurance contributions
I.2	Interesat	3,305	Interest
1	Të Brendshme	2,481	Domestic
2	Të Huaja	824	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,204	Operational & Maintenance
I.4	Subveclonet	54	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	10,263	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,332	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	1,931	Health insurance
3	Fondi i kompensimit te pronareve	0	Expenditures for Owners Compensation
I.7	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,399	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	834	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	801	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-8	Compensation for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	1,221	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	46	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,175	Foreign financed
V.	DEFICITI	8,816	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-8,816	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-8,862	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	204	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,503	Domestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	2,513	Other
2.2	Lokale	-10	Foreign
3	Të tjera	-11,559	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-499	Government deposits into the Central Bank
5	Të tjera	-11,062	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	Deposits of Social and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	69	Preservation stock
8	Nënhua	94	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	621	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	0	Other-Float
V.3	I huaj	36	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	4,002	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	242	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-3,161	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-805	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	0	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

Tabela e investimeve 2016

Table of investments 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data) në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	
Financim i brendshëm	46	Domestic financing
<i>Në %</i>	<i>3.77</i>	<i>In %</i>
Financim i huaj	1,175	Foreign financing
<i>Në %</i>	<i>96.23</i>	<i>In %</i>
Totali	1,221	Total
<i>Në %</i>	<i>100</i>	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6

TË ARDHURAT DOGANORE 2016 (CUSTOMS REVENUES 2016)*Të dhëna progresive (Progressive Data)* në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	
Taksë doganore	398	Customs Duties
TVSH	6,039	V.A.T
Akcizë	2,789	Excises
Të tjera	160	Others
Renta Minerare	160	
TOTALI	9,386	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2015 (TAX REVENUE)

TVSH	4,030	V.A.T
Akciza	0	Excises
Tatim mbi fitimin	1,477	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,218	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,027	National taxes
TOTALI	11,751	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	21,137	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2016

The Deficit and Its Financing for 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	
TË ARDHURAT	32,526	REVENUE
SHPENZIMET	23,710	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	8,816	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-8,816	FINANCING
Financimi i brendshëm	-8,852	Domestic
a. Bono Thesari Neto	-995	Treasury bills
b. Obligacione	3,508	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	-3,258	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-499	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	69	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	204	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-8,372	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-10	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	36	Foreing
a. Hua afatgjatë	4,002	Long-term foreign borrowing (gross)
nga e cila: nënhua	242	
b. <i>Ndryshimi I gjëndjes së arkës</i>	-3,161	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-805	Repayments
Mbeshjetje Buxhetore	0	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	6M_I 2014	3M_III 2014	9M_2014	3M_IV 2014	Viti 2014	3M_I 2015	3M_II 2015	3M_III 2015	
Llogaria korente	-1,026.70	-271.50	-341.00	-612.50	-313.20	-925.70	-377.50	-1,303.20	-262.00	-170.50	-325.50	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-426.20	-511.40	-937.60	-560.70	-1,498.30	-638.30	-2,136.60	-489.00	-488.20	-608.40	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	212.40	264.90	477.30	228.80	706.10	219.20	925.30	171.90	250.30	175.00	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-638.60	-776.30	-1,414.90	-789.50	-2,204.40	-857.50	-3,061.90	-660.90	-738.50	-783.40	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	30.00	38.10	68.10	97.90	166.00	102.40	268.40	90.20	127.90	133.90	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	396.40	487.10	883.50	610.00	1,493.50	538.00	2,031.50	417.70	455.40	601.10	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	366.40	449.00	815.40	512.10	1,327.50	435.60	1,763.10	305.4	327.50	467.2	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-20.60	-43.30	-63.90	-48.70	-112.60	-47.00	-159.60	-43.90	-20.50	-23.10	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	28.70	25.80	54.50	28.30	82.80	27.80	110.60	27.20	24.70	30.30	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-49.30	-69.10	-118.40	-77.00	-195.40	-74.80	-270.20	-71.10	-45.20	-53.40	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	145.30	175.60	320.90	198.30	519.20	205.40	724.60	180.70	210.30	172.10	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	172.60	204.40	377.00	230.60	607.60	244.20	851.80	211.90	243.30	214.70	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	20.70	-27.30	-28.80	-56.10	-32.30	-88.40	-38.80	-127.20	-31.20	-33.00	-42.60	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	22.50	22.40	44.90	20.70	65.60	21.10	86.70	26.00	21.30	45.60	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-161.90	-184.20	-346.10	-363.00	-709.10	-247.20	-956.30	-299.20	-201.00	-423.70	Financial Account
Investime direkte	893.10	-168.00	-150.40	-318.40	-253.50	-571.90	-229.40	-801.30	-273.90	-200.50	-231.00	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	14.50	14.00	28.50	-12.40	16.10	104.70	120.80	-79.10	-71.30	-12.70	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-8.40	-47.80	-56.20	-97.10	-153.30	-122.50	-275.80	109.70	106.90	-181.70	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	49.90	104.20	154.10	86.40	240.50	70.50	311.00	26.50	-35.60	168.80	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	-37.20	-30.20	-67.40	156.90	89.50	-38.70	50.80	55.90	-19.90	314.30	Overall Balance
								0.00				
Rezervat	-104.40	-40.30	22.50	-17.80	154.00	136.20	-39.00	97.20	111.80	16.20	312.50	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	-3.20	52.80	49.60	-2.90	46.70	-0.30	46.40	55.90	36.10	-1.80	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 9 MJETET VALUTORE NETO
Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Millions of Lek End of Period
						Janar Jan	
Mjetet valutore neto	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	365,578.1	367,149.1	Net Foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	276,475.7	288,142.1	294,111.3	318,940.2	407,569.6	409,106.2	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	20,817.8	21,602.1	19,913.2	26,841.9	41,991.5	41,957.1	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	63,428	62,316.5	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	57,098.0	55,145.6	44,503.1	55,198.3	48,752	48,396.8	
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	67,590.8	68,057.8	66,768.8	71,831.3	75,143.9	75,218.0	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	10,492.8	12,912.2	22,265.7	16,633.0	26,391.9	26,821.2	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	12,987.1	12,237.0	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	37.3	33.9	33.9	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,908.5	1,911.7	1,835.8	1,741.7	1,655.1	1,648.9	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	289,809.0	297,721.9	308,073.7	332,899.3	383,972.8	380,683.3	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	2,432.0	1,125.1	787.9	1,093.8	451.8	175.7	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	901.1	1,306.1	1,309.8	14.8	34.2	11.3	Other accounts payable
Të tjera neto	-12,984.4	-14,702.6	-14,102.8	-15,170.5	-15,208	-15,029.1	Other items net
Aksione	59,992.0	59,947.5	45,971.3	55,786.1	59,755.4	63,624.5	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Million of Lek End of Period
						Janar Jan	
Totali i kredisë	541,899.9	554,732.2	547,927.6	559,986.7	546,451	542,790.7	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	147.20	193.9	256	777.7	887.7	880.2	Credits to local Government
Në lekë	147.20	193.9	256	777.7	887.7	880.2	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	18,678.5	23,780.7	24,961	27,328.1	27,419.7	27,419.6	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	8,446.2	18,474.3	20,251.4	22,402.3	22,326.1	22,258.0	in Lek
Në valutë	10,232.3	5,306.4	4,709.6	4,925.8	5,093.6	5,161.6	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	364,373.9	370,993.0	363,541.2	372,166.5	355,725.2	353,032.2	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	108,321.7	121,808.7	122,944.7	129,429.4	129,233.7	127,448.2	in Lek
Në valutë	256,052.2	249,184.3	240,596.5	242,737.1	226,491.5	225,584.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9,841.9	10,162.9	9,578.2	8,270.3	9,537.7	8,434.0	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	3,364.2	4,031.7	4,238.4	3,436.9	5,036.2	3,744.7	in Lek
Në valute	6,477.7	6,131.2	5,339.8	4,833.4	4,501.5	4,689.3	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	148,858.4	149,601.7	149,591.2	151,444.1	152,880.7	153,024.7	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	68,499.9	70,614.1	72,242.5	77,396.7	82,897.3	82,719.2	in Lek
Në valutë	80,358.5	78,987.6	77,348.7	74,047.4	69,983.4	70,305.5	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Mujor-Monthly
							Janar Jan	Millions of LEK End of Period
Baza monetare	283,453.5	289,809.5	297,721.9	308,073.7	332,899.3	383,972.8	380,683.3	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	-0.5	5.4	2.7	3.5	8.1	15.3	1.1	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave deponituese	195,059.0	194,923.4	192,705.1	198,892.7	217,665.6	239,218.1	235,588.8	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	-6.7	-0.1	-1.1	3.2	9.4	14.0	9.6	Y/Y change in %
Depozita	785,225	875,230	930,703	950,088.4	977,420	687,060.3	544,815.0	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	18.5	10.5	6.3	2.1	2.9	-27.7	-42.7	Y/Y change in %
Agregati M1	275,427.3	276,898.3	281,246.6	295,876.5	353,321.7	384,108.2	374,877.8	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	-3.2	0.5	1.6	5.2	19.4	8.7	8.3	Y/Y change in %
Agregati M2	604,517.3	647,007.8	669,577.1	693,172.2	722,356.7	723,744.6	712,281.4	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	4.6	7.0	3.5	3.5	4.2	0.2	-0.3	Y/Y change in %
Agregati M3	980,283.9	1,070,153.7	1,123,407.8	1,148,980.9	1,195,086.3	1,217,870.1	1,211,534.4	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	12.5	9.2	5.0	2.3	4.0	1.9	2.0	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare								Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	252,827.8	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	365,578.1	367,149.1	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	72,244.3	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	63,428.0	62,316.5	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	57,937.1	57,098.1	55,145.6	44,503.1	55,198.3	48,752.0	48,396.8	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera deponituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	12,987.1	12,237.0	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Millions of Leks End of Period
							Janar Jan		
Në lekë	409,459	452,085	476,872	494,279.5	504,691	493,142	486,859		In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	80,369	81,975	88,541	96,983.9	135,656	153,506	149,455		Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	948.1	1,157.4	1,059.7	1,305.0	2,047.5	1,473.8	1,530.5		Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,134.0	7,303.4	7,168.0	6,108.2	9,799.5	8,736.2	7,847.6		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	920.6	532.5	1,789.2	937.0	1,919.8	1,258.9	1,439.3		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	22,505.0	20,681.5	24,716.6	24,244.0	38,198.6	40,993.6	35,767.0		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	48,860.8	52,300.1	53,807.9	64,389.7	83,690.6	101,043.0	102,870.4		Other resident sectors
Depozita të tjera	329,090	370,110	388,331	397,295.6	369,035	339,636	337,404		Other deposits
Qeveria lokale	55.1	109.6	19.4	57.1	7.8	29.9	19.3		Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,054.3	2,608.9	1,715.4	1,257.8	1,167.9	815.0	850.0		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,773.4	1,423.5	2,224.4	2,556.5	1,730.1	3,573.4	3,221.7		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	8,316.8	11,292.5	10,954.1	14,523.4	11,772.0	11,292.1	12,324.0		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	315,890.5	354,675.1	373,417.3	378,900.8	354,357.3	323,926.0	320,988.7		Other resident sectors
Në valutë	375,767	423,146	453,831	455,808.9	472,729	193,918	56,700		In foreign currency
Qeveria lokale	493.0	280.5	44.5	372.6	231.3	209.5	249.0		Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,201.0	5,242.2	4,011.2	4,486.2	7,099.6	3,645.4	2,653.7		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	8,572.0	6,022.3	6,303.3	6,673.1	4,872.9	2,641.2	1,256.1		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	57,382.9	54,418.4	46,867.5	49,382.3	55,834.3	53,618.9	52,541.6		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	303,117.7	357,182.4	396,604.2	394,894.7	404,691.2	133,803.4			Other resident sectors
Totali	785,225	875,230	930,703	950,088.4	977,420	687,060	544,815.0		Total
Qeveria lokale	1,496.2	1,547.5	1,123.6	1,735	2,286.6	1,713.2	1,798.8		Local governments
Korporata jofinanciare publike	16,389.3	15,154.5	12,894.6	11,852.2	18,067.0	13,196.6	11,351.3		Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,266.0	7,978.3	10,316.9	10,166.6	8,522.8	7,473.5	5,917.1		Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,204.7	86,392.4	82,538.2	88,149.7	105,804.9	105,904.6	49,347.1		Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	667,869.0	764,157.6	823,829.4	838,185.2	842,739.1	558,772.4	476,400.7		Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH

Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Millions of Lek End of period
						Janar	Jan	
AKTIVET	384,581	394,834	398,814	433,878	512,722	513,359		
Total	48,572	48,288	40,652	51,880	126,301	120,822		Total
Mbajtjet e SDR	8,226.5	8,789.7	10,508.0	19,299.7	30,578.8	31,022		SDR holdings
Arka në valutë	59.8	67.5	57.3	56.2	84.9	24.9		Foreign currency
Depozitat	40,286	39,431.1	30,086.2	32,524.0	95,637.2	89,775.0		Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	284,210	294,007	308,387	320,745	323,679	330,930		Securities other than shares
Jorezident	219,718.8	229,313.1	243,178.6	256,796.7	270,453.6	277,674		nonresidents
Qeveria qendrore	64,490.8	64,694.1	65,208.4	63,947.9	53,225.5	53,256.1		central government
Huatë	27,388	23,707	23,333	27,286	14,641	13,885		Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-		Central Government
Korporata të tjera depozituese	25,485.4	21,800.2	21,502.3	25,547.8	12,987.1	12,237		Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,902.8	1,906.5	1,830.9	1,738.5	1,654.0	1,647.5		Other resident secotrs
Derivatet financiare	35.3	14.2	31.5	17.4	27.7	17.0		Financial derivatives
Llogari të arketueshme	11,295.9	14,129.2	11,994.1	18,197.8	32,775.5	32,623.0		Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	13,080.0	14,688.0	14,416.4	15,752.1	15,298.1	15,083.0		
DETYRIMET	384,581	394,834	398,814	433,878	512,722	513,359		LIABILITIES
Total	203,009	201,086	208,042	226,588	241,006	237,031		Total
Para në qarkullim	202,906.6	200,898.7	207,792.7	226,434.1	239,218.1	235,589		Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	102.8	187.3	249.7	154.2	1,787.9	1,442.4		Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	108,017	120,691	132,765	140,569	201,586	202,351		Deposits excluded from broad money
Jorezident	8,318.7	10,042.9	9,706.5	16,564.1	31,826.2	31,755		Nonresidents
Qeveria qendrore	10,465.6	12,887.1	22,239.2	16,600.5	26,340.8	26,769		Central government
Korporata të tjera depozituese	88,570.2	97,054.7	100,031.3	106,310.9	142,966.8	143,652		Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	20.5	37.2	62.5	85.0	87.4	88		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	641.5	669.2	725.4	1,008.8	364.4	88		
Huatë	4,852	3,871	2,919	2,294	1,810	1,785		-
Jorezidentët	4,852.0	3,870.7	2,919.3	2,294.2	1,809.6	1,785		Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-		Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-		Other depository corporations
Llogari të pagueshme	1,064.3	1,680.5	1,828.3	886.8	461.1	408		Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,647.1	7,557.9	7,287.5	7,753.2	8,104.4	8,160		SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	59,992	59,947.5	45,971.3	55,786.1	59,755.4	63,625		Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania